



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 51, Datë 26.03.2020

MBI

DISA NDRYSHIME TË PËRKOHËSHME NË PROCEDURAT E LICENCIMIT NË USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR NË KUADËR TË MASAVE PAS SHFAQJES SË VIRUSIT COVID-19 DHE SHPALLJES SË GJËNDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE NË VENDIN TONË.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 16 të Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për Sektorin Gazit Natyror”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.Nr.243, datë 24.3.2020 “Per shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Vendimin e datës 09.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Perhapur nga Coronavirus i ri, nenit 16 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.03.2020 mbasi shqyrtoi relacionin “Për disa ndryshime të përkohëshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19, dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”.

Konstatoi se:

- Aktualisht në vend është shpallur gjendja e epidemisë për shkak të Covid 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar disa akte normative mbi masat për parandalimin e Virusit Covid 19 duke përcaktuar ndër të tjera edhe kufizim në qarkullimin e njerëzve por edhe kufizim të disa aktiviteteve që nuk do të lejohen gjatë gjendjes së virusit Covid 19.
- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr..243, datë 24.03.2020 është vendosur për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- Në këtë vendim gjithashtu në pikën 6.2 përcaktohet ndër të tjera që Institucionet publike:

a) të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;

d) të kufizojnë aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë;

e) të kufizojnë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm për të gjitha organet publike;

- Në kuptim të akteve normative dhe sic bërë publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, një sërë aktivitetesh janë mbyllur. Ndërkohë aktivitetet që lidhen me sigurimin e energjisë elektrike vijojnë të ushtrohen.
- Në kuptim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, aktivitetet e prodhimit transmetimit shpërndarjes furnizimit dhe tregtimit në sektorët respektive ushtrohen si aktivitete të licensuara nga ERE.
- Disa akte normative janë nxjerë në kuadër të gjendjes që lidhen me epideminë e Covid 19.
- Edhe insitucionet publike kanë marrë masa përfshirë pezullimin apo reduktimin e aktiviteteve. Të tillë janë Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 127, datë 10.03.2020 "Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, e me tej Vendimi Nr.128, datë 24.03.2020 "Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë".
- Mbështetur në aktet normative dhe Vkm nr.Nr.243, datë 24.3.2020, institucionet e administratës publike, po kryejnë funksionet e tyre organike, për aq sa është e mundur nëpërmjet platformave online, me qëllim kufizimin e aksesit të publikut në ambiente me frekuentim të gjerë.
- Në rregulloret për procedurat e licencimit të miratuar nga ERE, ndër të tjera kërkohet edhe depozitimi i vërtetimeve që lidhen me gjendjen gjyqësore.
- Në kushtet që siç njoftuar në vendimet e mësipërme aktiviteti i gjykatave është pezulluar marrja e këtyre vërtetimeve në kuadër të një aplikimi për licensim do të ishte e pamundur.
- Në kushtet e aktivitetit të kufizuar të veprimtarisë së shumë organeve të administratës shtetërore, sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për procedurën e rinovimit të licencave apo dhe dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e kushteve të licencimit të subjekteve të licensuar me kusht nga ERE, bëhet i pamundur.
- Për adresimin e këtyre problematikave, vlerësohet e përshtatshme vendosja e një periudhe tranzitore në lidhje me disa ndryshimet të përkohshme në procedurat e licencimit për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19-S dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë,

- Kjo masë do të shërbejë për të reduktuar edhe aktivitetet e institucionit sic edhe Vkm Nr.243, datë 24.03.2020 përcakton, dhe mbi të gjitha duke ditur që në thelb të procesit të rinovimit të një licence është pajisja me vërtetimet mbi gjendjen gjyqësore, si të tillë gjykohet që:
 - Të gjitha licencat afati i të cilave përfundon jo më vonë se në 30 qershor 2020 nuk do t'i nënshtrohet një procesi rinovimi.
 - Subjektet që dëshirojnë të rinovojnë licencën në një nga aktivitetet e licencuara nga ERE do të kenë detyrimin e kryerjes së një procesi rinovimi, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.
 - Të gjitha vendimet e licencimit me kusht, afati i plotësimit të të cilit përfundon jo më vonë se në 30 qershor 2020, u shtyhet afati i kushtit të parashikuar në vendimin e ERE deri jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.
- Së fundmi një çështje tjetër e lidhur me situatën e epidemisë Covid 19 ka të bëjë me reduktimin e aktivitetit të subjekteve mediatike ku nga mediat e shtypit të shkruar është bërë me dije se këto media ofrojnë botimet vetëm përmes botimeve online.
- Për të realizuar kërkesat e ligjeve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në lidhje me publikimin në gazetë të njoftimeve për aplikim për licencim, deri në përfundim të epidemisë së Covid 19 mund vlerësohet të vijohet me botimin online në media.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, gërma “d” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215/2019 si dhe nenit 9 pika 1 gërma d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror” miratuar nga Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 97, datë 04.07.2017
2. Subjektet e licencuar gjatë kësaj periudhe kanë detyrimin për t'i paraqitur jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19 vërtetimet e përcaktuara në nenin 9, pika 2, gërma “d” të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215/2019 si dhe nenit 9 pika 1 gërma d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror” miratuar nga Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 97, datë 04.07.2017.
3. Të gjitha licencat që përfundojnë deri në 30 qershor 2020 nuk do t'i nënshtrohen një

procesi rinovimi. Këto subjekte kanë detyrimin për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.

4. Subjektet që nuk dëshirojnë të rinovojnë licencat u garantohet e drejta për të njoftuar ERE për këtë vullnet të tyre dhe automatikisht pas përfundimit të licencave të dhëna më parë do të hiqen nga regjistri i të licencurve në përfundim të afatit të licencës së mëparëshme.
5. Pëzullimin e afateve të plotësimit të kushteve që lidhen me plotësimin e dokumentacionit, të përcaktuara në licencat e dhëna nga ERE në një nga veprimtaritë e parashikuara në Ligjin nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, I ndryshuar, si dhe ligjin nr.102/2015 “Për Sektorin e gazit Natyror” i ndryshuar, deri jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë Covid 19.
6. Vendosjen e një periudhe pa afat nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës njoftimi në median e shkruar sipas nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215/2019, dhe nenit 10 pika 8 të "Rregullores procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror", miratuar nga Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 97, Date 04.07.2017, do të realizohet përmes botimit online.
7. Të gjitha vendimet e licencimit të marra gjatë kësaj periudhe do të jenë objekt i rishikimit në kuadër të dorëzimit të dokumentacionit përkatës jo më vonë se 1 muaj nga përfundimi i epidemisë Covid 19.
8. Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare për veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendrike për aktivitet në sektorin e gazit natyror.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI